

Vendim nr. 238 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 10 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KONSTANDIN KOSTRISTA**, përfaqësuar nga avokat Sokol Gjini, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1504, datë 06.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1594, datë 18.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, pika 1, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me anë të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në vitin 2007 kërkuesi ka fituar bashkëpronësinë mbi një tokë truall në qytetin e Kavajës. Rezulton se më pas shtetasi Ll.P. ka ndërtuar një objekt informal mbi një pjesë të këtij trualli në bashkëpronësi. Në këto kushte, kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë i janë drejtuar gjykatës duke kërkuar lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës, prishjen e ndërtimeve pa leje në të, shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 94, datë 29.01.2010, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit dhe detyrimin e të paditurit të lirojë dhe dorëzojë sipërfaqen e truallit prej 168 m², e cila i ishte mbivendosur pronës së kërkuesit dhe bashkëpronarëve të tjerë.

3. Ndërkohë shtetasi Ll.P. ka filluar procedurat e legalizimit të objektit informal dhe në përfundim të tyre, Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale Tiranë (ALUIZNI), nëpërmjet lejes nr. 2684, datë 31.03.2010 (*leja e legalizimit*), i ka legalizuar shtetasit Ll.P. sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 235.2 m² dhe sipërfaqen e ndërtimit prej 47.5 m².

4. Në bazë të ankimit të të paditurit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 276, datë 28.03.2012, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 425, datë 14.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Kavajë.

5. Kërkuesi ka filluar një proces të dytë gjyqësor, këtë herë duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së lejes së legalizimit, pasi ishte në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5546, datë 20.05.2013, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së lejes së legalizimit. Kundër vendimit ka ushtruar ankim i padituri dhe ALUIZNI, Drejtoria Rajonale e Qarkut Tiranë.

6. Pas marrjes së akteve për kompetencë nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1504, datë 06.04.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekursin e kërkuesit dhe me vendimin nr. 00-2024-1594 (166), datë 18.04.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

8. Në datën 13.08.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në

datën 14.08.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, për rrjedhojë edhe *të drejtën e pronës private*, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, në tejkalim të kompetencave të saj, ka deformuar objektin e gjykimit dhe ka dalë jashtë kufijve të shqyrtimit të çështjes. Vendimi i saj bie në kundërshtim të hapur me ligjin për legalizimin, duke cenuar në këtë mënyrë dhe parimin e shtetit të së drejtës, ligjshmërisë dhe hierarkisë së akteve.

9.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi në vijim të legalizimit të objektit informal mbi pasurinë e kërkuetit dhe bashkëpronarëve të tjerë, ai nuk është dëmshpërblyer sipas parashikimeve ligjore, duke u vënë në pozita inferiore dhe të pabarabarta përpara ligjit kundrejt personave të tjerë në të njëjtën situatë faktike.

9.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuetit, por, në cenim edhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë të paanshme, ka dalë hapur në mbështetje të palës tjetër. Ajo gjykatë e ka ndryshuar tërësisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por pa e arsytuar fare atë dhe duke u mjaftuar me argumente të rumbullakosura se si zgjidhja e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit ishte e drejtë. Ajo, gjithashtu, ka bërë një interpretim të ngushtuar, të gabuar, dashakeq dhe rëndues të ligjit për legalizimet, duke u treguar e njëanshme.

9.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi kërkueti kishte sigurinë juridike të vendosur nga gjykata e shkallës së parë me vendim se ai objekt nuk do të legalizohej dhe se nuk do të ligjërohej e gjithë procedura e paligjshme e ndjekur nga organet shtetërore. Prandaj Gjykata e Lartë ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të kërkuetit me vendimmarrjen e saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

11. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ai ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji konstaton se kërkuessi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual dhe pavarësisht objektit, në përmbajtje të tij ka ngritur pretendime vetëm për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Kërkesa përmbush kriterin paraprak të legjitimitit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar mban datën 18.04.2024, ndërsa kërkesa në Gjykatë është paraqitur në datën 13.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuessi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, për rrjedhojë edhe të së drejtës së pronës private,

në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit. Këto pretendime kërkuesi i ka lidhur me procesin e dytë gjyqësor dhe pavarësisht objektit të ankimit, i ka ngritur vetëm kundrejt vendimit të Gjykatës së Lartë.

15. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Kolegji vëren se kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë, në tejkalim të kompetencave të saj, ka deformuar objektin e gjykimit dhe ka dalë jashtë kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe se vendimi i saj është në kundërshtim me ligjin për legalizimin. Mirëpo, ky pretendim i kërkuesit është i përgjithshëm, pasi nuk është argumentuar se si ajo gjykatë i ka tejkualuar kompetencat e saj dhe në cilën mënyrë e ka deformuar ajo objektin e gjykimit, duke mos e ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues. Për më tepër, Kolegji vëren se ky pretendim, në thelb, lidhet me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, që nuk përbën lëndë kushtetuese. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, duke argumentuar se ai kishte pritshmërinë që Gjykata e Lartë do ta konstatonte paligjshmërinë e procedurës së ndjekur për legalizimin e objektit informal dhe fajësinë e organeve shtetërore në ardhjen e pasojës së paligjshme, njësoj si gjykata e shkallës së parë. Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të ngrejë në nivel kushtetues as këtë pretendim, pasi e ka lidhur cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme me interpretimin e gabuar të ligjit nga Gjykata e Lartë, përkundrejt interpretimit të drejtë të bërë nga gjykata e shkallës së parë. Ndaj edhe ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e barazisë përpara ligjit, për shkak se ai nuk është dëmshpërblyer në vijim të procesit të legalizimit, duke e vënë atë në pozitë inferiore e të pabarabartë përpara ligjit kundrejt personave të tjerë në të njëjtën situatë faktike me kërkuesin. Referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se me vendimin nr. 900, datë 06.12.2011 Këshilli i Ministrave ka vendosur, ndër të tjera, miratimin e kompensimit të kërkuesit si ish-pronar në vlerë leku për sipërfaqen e parcelës që ka kaluar në favor të shtetasit Ll.P. Në këtë situatë, Kolegji çmon se as ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim, pasi është haptazi i pabazuar.

18. Ndërsa, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, duke e lidhur këtë pretendim me vendimin e Gjykatës së Lartë, *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohet në vijim për bazueshmërinë e tij.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private

19. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, por, në cenim edhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme, ka dalë hapur në mbështetje të palës tjetër. Ajo gjykatë nuk e ka arsyetuar fare vendimin, duke u mjaftuar me argumente të rrumbullakosura. Ajo, gjithashtu, ka bërë një interpretim të ngushtuar, të gabuar, dashakeq dhe rëndues të ligjit për legalizimet.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 19.01.2018; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka gjetur kërkimet e kërkuarit të bazuara në ligj dhe në prova, për pasojë ka pranuar kërkesëpadinë dhe ka konstatuar pavlefshmërinë e lejes së legalizimit. Sipas asaj gjykate, ndonëse për atë konflikt pronësor ishte shprehur gjykata, ALUIZNI ka vijuar procesin e legalizimit në kundërshtim të hapur me procedurat e legalizimit të ndërtimeve informale. Çdo person apo institucion, sipas saj, është i detyruar ligjërisht të respektojë dhe zbatojë vendimin gjyqësor, pasi supremacia e vendimit gjyqësor ndaj aktit administrativ është e padiskutueshme.

22. Ndërsa gjykata e apelit ka vendosur të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të rrëzojë padinë. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka bërë një interpretim të gabuar

të shkakut të padisë dhe dispozitave ligjore, duke arritur në përfundimin e gabuar. Po sipas asaj gjykate, asnjëra nga dispozitat e referuara nga gjykata e shkallës së parë nuk është e zbatueshme në rastin konkret. Konkretisht, referimi në nenin 26 të ligjit është i gabuar, pasi në të parashikohet pezullimi i procedurës së legalizimit në rastet e mosmarrëveshjeve për raportet e pronësisë për objektin informal ose pretendime të personave të tjerë për parcelën ndërtimore, ndërsa në rastin në shqyrtim, sipas gjykatës së apelit, e drejta e kërkuarit ish-pronar është kufizuar nga vetë ligji për legalizimin, në zbatim të të cilit Këshilli i Ministrave ka vendosur fillimisht miratimin e kalimit të pronësisë mbi poseduesin e objektit informal dhe më pas ka vendosur miratimin e kompensimit të kërkuarit ish-pronar në vlerë leku për sipërfaqen e parcelës e cila ka kaluar në favor të shtetasit Ll.P. Ajo gjykatë ka vlerësuar të gabuar edhe referimin në nenin 40 të ligjit për legalizimin, pasi nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për sigurimin e padisë në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë. Për rrjedhojë, sipas saj, pala e paditur nuk kishte asnjë detyrim për të pezulluar procedurën e legalizimit.

23. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuarit, si dhe vendimet e gjykatave më të ulëta, në ushtrimin e rolit të saj, ka vlerësuar se arsyetimi dhe përfundimi që ka arritur gjykata e apelit në vendimin e saj është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit dhe për këtë arsye ka vendosur lënien në fuqi të atij vendimi. Kolegji vëren se arsyetimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me dispozitat e referuara dhe zbatueshmëria e tyre në rastin konkret janë në një linjë me atë të gjykatës së apelit. Kolegji vëren, gjithashtu, se ai kolegji ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e kërkuarit për kufizimin e së drejtës së pronësisë, duke e gjetur atë të pabazuar. Në këtë konkluzion ka arritur duke iu referuar edhe jurisprudencës kushtetuese, sipas të cilës duke qenë se ligji për legalizimet ka për objekt urbanizimin e zonave informale dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës, ekziston në këto raste “interesi publik” që mund të justifikojë shpronësimin e pronarëve të ligjshëm dhe kalimin e pronave të tyre në pronësi të ndërtuesve të ndërtimeve pa leje. Përcaktimi i bërë nga ligji për legalizimet, sipas të cilit, pronësia e tokës së shpronësuar nuk i mbetet shtetit, por i transferohet zotëruesit të ndërtesës që legalizohet, në vetvete nuk përbën një pengesë që ky përcaktim të konsiderohet si i domosdoshëm për “interesi publik” (*shih vendimin nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Këto procedura, sipas Gjykatës së Lartë, vlerësohet se justifikojnë “kufizimin” e pronësisë së pronarëve, deri në përfundimin pozitiv apo negativ të procedurave të legalizimit, në përfundim të të cilave nëse pronari zhvishet nga pronësia, ai kompensohet, e nëse refuzohet legalizimi, ndërtimi i paligjshëm priset dhe pronari rivendoset në të drejtat e tij.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i kundërshtuar pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese mbi të cilën ajo gjykatë ka dhënë vendimin e saj, në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante shkaqe të bazuara në themel nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, ndërsa e ka vlerësuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit të drejtë dhe se duhej të lihej në fuqi. Përkundër pretendimit të kërkuesit, vendimi i asaj gjykate nuk rezulton të ketë pamjaftueshmëri argumentesh apo mos të ketë kthyer përgjigje për pretendimet e tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi objekt kundërshtimi përmbush mjaftueshëm standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe se pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

25. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimi i ndërlidhur për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.